



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 26.2.2025

Nr. 207

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA PËR  
EUROPIANIZIM DHE INTEGRIMIN E SHQIPËRISË” ME KRYETAR Z. RIVELINO  
ÇUNO, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR  
KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 26.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1291 prot., datë 25.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, me kryetar Z. Rivelino Çuno
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 26.2.2025 Nr: 207  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, me Kryetar Z. Rivelino Çuno, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

“Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Rivelino Çuno, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, me initiale “PEISH”, me Kryetar Z. Rivelino Çuno, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë” me shkronja nistore “PEISH”, me adresë: Rruga "Dhimitër Shuteriqi", Pll. Hawaii Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Rivelino Çuno, me adresë Rruga "Dhimitër Shuteriqi", Pll. Hawaii Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Kledia Boçe, me adresë: Rruga "Dhimitër Shuteriqi", Pll. Hawaii Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Rivelino Çuno, me adresë: Rruga "Dhimitër Shuteriqi", Pll. Hawaii, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit

të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, me kryetar Z. Rivelino Çuno, me shkronjat nistore “PEISH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**